



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P.41/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.01.2021, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Kundërshtimi i vendimit të KVO lidhur me vlerësimin në pikë të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65733-07-16-2020, me objekt: Loti IV “Mirëmbajtje me performancë K/Sauk - Sanatorium, Sauk - Km 29 - rot. re Shijon - Ura e Zaranikës, Km22 - Qytezë Krrabë - Objekti X, Rotondo Sauk - Sauk i Vjetër, Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj, Vaqarr - Vishaj”, me fond limit 263.424.859 (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Kundërshtimi i vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin me pikë si dhe skualifikimin e operatorëve ekonomikë “2T” sh.p.k. dhe bashkimin e operatorëve ekonomike “Alko Impex General Konstruktion” d.sh.h. & “Alko Impex Konstruktion” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Victoria Invest” sh.p.k.
Lagja “28 Nëntori”, Rruga “11 Nëntori”, Pll. pranë Tatim Taksave, Elbasan

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rr. “Sami Frashëri”, nr.33, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga BOE ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, BOE ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 17.07.2020 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65733-07-16-2020, me objekt: Loti IV “Mirëmbajtje me performancë K/Sauk - Sanatorium, Sauk - Km 29 - rot. re Shijon - Ura e Zaranikës, Km22 - Qytezë Krrabë - Objekti X, Rotondo Sauk - Sauk i Vjetër, Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj, Vaqarr - Vishaj”, me fond limit 263.424.859 (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 9601/1 datë 14.12.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 7.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Në këtë fazë kanë marrë pjesë operatorët si më poshtë.

- | | |
|--|----------------|
| - “2T” sh.p.k. | I kualifikuar |
| - “Alko Impex General Contruction” sh.p.k. | I kualifikuar |
| - “I.D.K. Konstruksion” sh.p.k. | I kualifikuar |
| - “Fusha” sh.p.k. | I skualifikuar |
| - “Albavia” sh.p.k. | I skualifikuar |
| - “Igma” sh.p.k. | I skualifikuar |
| - “Victoria Invest” sh.p.k. | I kualifikuar |

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 08.09.2020 është regjistruar ankesa nr. 6522prot, dhe në datën 18.09.2020 i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes duke refuzuar ankesën. Referuar po informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 01.10.2020 me shkresën nr.4794/9 nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 19.10.2020 ora 11:00. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

Nr.	Operatori ekonomik	Çmimi total i ofertës në leke (pa përfshirë vlerën në TVSH-së)	
		Para korrigjimit	Pas korrigjimit
1	“I.D.K. Konstruksion” sh.p.k.	236.705.563,2	
2	Boe Alko Impex General Contruction” dshh & Alko Impex General Contruction” sh.p.k.	223.281.127,8	
3	“2T” sh.p.k.	199.614.567,2	
4	“Victoria Invest” sh.p.k.	181.127.041,2	

II.4. Në datën 12.11.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. BOE "I.D.K. Konstruksion" sh.p.k. & "4-A-M" sh.p.k.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në % $\sum 1+2+3$
1	236.705.563,2	77	50	100	227
2	236.705.563,2	76	50	100	226
3	236.705.563,2	76	50	100	226

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 226.333 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë"

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në % $\sum 1+2+3$
1	236.705.563,2	46.2	10	20	76.2
2	236.705.563,2	45.6	10	20	75.6
3	236.705.563,2	45.6	10	20	75.6

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 75.8 pikë.

2. BOE Alko Impex General Contruction" dshh & Alko Impex General Contruction" sh.p.k.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në % $\sum 1+2+3$
1	223.281.127,8	81	100	100	281
2	223.281.127,8	80	100	100	280
3	223.281.127,8	80	100	100	280

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 280.333 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë"

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në % $\sum 1+2+3$
------------------	------------------	-----------------------	--	--	-------------------------

1	223.281.127,8	48.6	20	20	88.6
2	223.281.127,8	48	20	20	88
3	223.281.127,8	48	20	20	88

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 88.2 pikë.

3. “2T” sh.p.k.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në % $\sum 1+2+3$
1	199.614.567,2	91	80	80	251
2	199.614.567,2	90	80	80	250
3	199.614.567,2	90	80	80	250

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 250.333 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në % $\sum 1+2+3$
1	199.614.567,2	54.6	16	16	86.4
2	199.614.567,2	54	16	16	86
3	199.614.567,2	54	16	16	86

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 86.133 pikë.

“Victoria Invest” sh.p.k.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në % $\sum 1+2+3$
1	181.127.041,2	100	45	60	205
2	181.127.041,2	100	45	60	205
3	181.127.041,2	100	45	60	205

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 205 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për emimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në % Σ 1+2+3
1	181.127.041,2	60	9	12	81
2	181.127.041,2	60	9	12	81
3	181.127.041,2	60	9	12	81

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 81 pikë.

Informacion shtesë: Nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të ankesave të ngritur në shqyrtimin e ankesës në Lotin 3 (Komision i cili është i njëjtë e Lotin 4), u kryen verifikime në shtetin e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe u konstatua se një sasi e konsiderushme mjetesh që janë marrë ose dhënë më qira për Lotin 3 ashtu dhe në Lotin 4 midis 3 (tre) kompanive 1- Victoria Invest International, 2- Victoria Invest dhe 3- Domastion Project shpk, rezultojnë të angazhuara në kontrata të lidhura me Ministrinë e Infrastrukturës për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale të shtetit të Kosovë, mjete këto që sipas Deklaratës oe Victoria Invest shpk deklararon se i disponon.(materiali bahkëngjitur)

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	BOE Alko Impex General Construction” dshh & Alko Impex General Construction” sh.p.k.	280.333	88.2
2	“2T” sh.p.k	250.333	86.133
3	“Victoria Invest” sh.p.k.	205	81
4	BOE “I.D.K. Konstruktion” sh.p.k. & “ 4-A-M” sh.p.k.	226.333	75.8

Referuar Procesverablit Nr. 4 Loti 4

Argumentet për pikëzimin nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave.

[...] Në lidhje me kriterin Cilësia (metodologjia e zbatimit të punimeve përvoja e personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimi i cilësisë plani i mobilizimit krahasimi është bërë midis kompanive konkurruese. Lidhur me kriterin Cilësia OE VICTORIA INVEST sh.p.k. ka paraqitur dokumentin e metodologjisë i përshkruar në 38 faqe nga të cilat 17 faqe janë figura të skemave të përkohshme të menaxhimit të trafikut në rast të punimeve në rrrugë (kopje materiali i specifikimeve teknike, pjesë e dokumentave të tendrit). Përveç të tjerave në faqen 4 të tij thuhet se do të ngrihen 2 qendra të mirëmbajtjes (pikat e mbështetjes dhe mirëmbajtjes PMM) në kuptimin e kantierëve të cilat do të shërbejnë si pika ndërhyrje të domosdoshme sidomos në sezonin dimëror. Në vijim përshkruhet vetëm një nga këto kantiere dhe konkretisht ai në Elbasan. Pra ky përshkrim është i paplotë (-1 pikë). Në vazhdim nuk evidentohet në asnjë dokument plani i sigurimit teknik(-1pikë). Gjithashtu mungon plani i menaxhimit të aksidenteve dhe ndihmës së shpejtë (-1 pikë). Gjithashtu mungon plani i menaxhimit social dhe mjedisor (-1 pikë). Dokumenti me planin e menaxhimit të cilësisë është paraqitur si material i përkthyer nga gjuha e huaj (i papërshtatur me gjuhën shqipe). Ky material nuk jep një panoramë të qartë të planit të menaxhimit të trafikut (-1 pikë). Më tej KVO në analizën e kriterit mbi disponueshmërinë e makinerive dhe pajisjeve konstatoi se një pjesë e mjeteve për të cilat operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë mos angazhimi rezulton të jetë e angazhuar në kontratën lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar për ndërtimin e lotit 3 të unazës së Tiranës. Megjithëse rezulton që ky operator të ketë bërë deklaratë të rreme, KVO vendos ta penalizojë me 3 pikë për këtë kriter.[...]

II.5. Në datën 18.11.2020 operatori ekonomik ankimues “Victoria Invest” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me vlerësimet me pikë të ofertës së tij ekonomike të paraqitur si dhe duke ngritur pretendime mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “2T” sh.p.k. dhe bashkimi i operatorëve ekonomike “Alko Impex General Konstruksion” d.sh.h. & “Alko Impex Konstruksion” sh.p.k., duke argumentuar si më poshtë vijon: [...]Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar tenderin me objekt loti 4 “Mirëmbajtje me performancë K/Sauk - Sanatorium, Sauk - Km 29 - rot. re Shijon - Ura e Zaranikës, Km22 - Qytezë Krrabë - Objekti X, Rotondo Sauk - Sauk i Vjetër, Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj, Vaqarr - Vishaj”, me fond limit 263.424.859 (pa TVSH),. Në fazën e parë të zhvilluar në datën 07.08.2020 janë kualifikuar 4 oe Alko Impex General Contruction” sh.p.k., “2T” sh.p.k., “Victoria Invest” sh.p.k., “I.D.K. Konstruksion” sh.p.k.[..]. Në fazën e dytë të zhvilluar në datën 19.10.2020 jkanë paraqitur ofertat financiare dhe dokumentacionin e kërkuar të gjithë oe e parakualifikuar në fazën e parë. Në datën 12.11.2020 jemi vënë në dijeni për vlerësimin nga KVO-ja e Ak-së për fazë e dytë si më poshtë vijon:

	Vlera të ofertuara	
Alko Impex General Contruction” sh.p.k.	265.80	I kualifikuar
“2T” sh.p.k.	258.60	I kualifikuar
“Victoria Invest” sh.p.k.	243.00	I kualifikuar
“I.D.K. Konstruksion” sh.p.k.	227.40	I kualifikuar

Dhe nuk na japin asnjë shpjegim tjetër për mënyrën e vlerësimit. Sipas këtij vlerësimi shoqëria jonë është renditur në vend të tretë.

I kemi kerkuar me shkrese AK qe te na beje me dije me procesverbalin e mbajtur per kete procedure, dhe AK ka vënë në dispozicion procesverbalin nr.5 date 12.10.2020 i vleresimit te propozimeve teknike dhe ekonomike. Me vlerësimin e bërë nga KVO-ja nuk jemi dakord dhe brenda afatit ligjor të parashikuar në LPP po ju paraqesim këtë ankesë.

Fillimisht KVO na bën me dije me ofertat financiare të OE.

“I.D.K. Konstruksion” sh.p.k.	236.705.563,2
Boe Alko Impex General Contruction” dshh & Alko Impex General Contruction” sh.p.k.	223.281.127,8
“2T” sh.p.k.	199.614.567,2
“Victoria Invest” sh.p.k.	181.127.041,2

Pra sic vërehet nga ofertat financiare shoqëria jonë ka ofertën më të lirë finaciare me diferencë të theksuar nga shoqëritë e tjera. Në fund të procesverbalit KVO jep renditjen përfundimtare:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	BOE Alko Impex General Contruction” dshh & Alko Impex General Contruction” sh.p.k.	280.333	88.2
2	“2T” sh.p.k	250.333	86.133
3	“Victoria Invest” sh.p.k.	205	81
4	BOE “I.D.K. Konstruksion” sh.p.k. & “4-A-M” sh.p.k.	226.333	75.8

Mënyra sesi ka arritur në këtë vlerësim kvo, është shpjegur në procesverbalin nr. 5 datë 12.10.2020 i vlerësimit të propozimeve teknike dhe ekonomike. Ju bëj me dije se kjo pikë mesatare në % dhe pikë nuk na rezulton e njëjtë me renditjen në faqen e app për vlerat e ofertuara.

Sipas dst referojmë kriterin e vlerësimit[...]

Dhe në dst nuk shpjegohet se si do të llogariten këto pikë për oe në bazë të kujt standarti do të referohen pikët maksimale e minimale.

Sipas procesverbalit të KVO-së

Çmimi më i ulët [0-60]

KVO na ka vlerësuar me 60 pikë për këtë kriter sepse ishim oferta më e lirë financiare.

Përsa i përket vlerësimit të KVO-së për cmimin më të ulët me 60pikë ekuivalente me 100% dhe cmimit më të shtrenjtë me 46.2 pikë ekuivalente 77%, ju theksojmë se ky lloj vlerësimi nuk përputhet

me kriteret e AK-së të paraqitura në dst. Pasi vet AK në dst ka shprehur që vlerësimi për cmimin do të jetë nga Opikë deri në 60 pikë që nënkupton që oe që do të ofertojë me cmim më të lartë (afër fondit limit) do të ketë vlerësim më të vogël (afër 0 pikëve) dhe oe që do të ketë cmimin më të ulët do të ketë pikët maksimale.

Theksojmë se oe jonë ka ofertuar cmimin më të ulët përkatësisht me 31% ulje nga fondi limit nga të gjithë oe e tjerë dhe si pasojë është vlerësuar me 60 pikë ndërkohë që operatori më i shtrenjtë me 46.2pikë apo 77% dmth edhe se një oe është më i shtrenjti është penalizuar vetëm 23%.

Mënyra e vlerësimit nuk është bërë në përputhje me dst që oe më i shtrenjtë të vlerësohet me pikët minimale. Prandaj kërkojmë rishikimin të vlerësimit për oe e tjerë duke i ulur pikët e dhëna nga KVO.

Theksojmë se për kriterin e punëve të ngjashme dhe cilësinë KVO ka vlerësuar Victoria Invest me 45% edhe pse i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dst të AK, dhe ka bërë vlerësim nën 50% kurse në kriterin e cmimit vlerësimi minimal i KVO-së është 76-77% për oe e tjerë.

Dmth edhe se një oe i ka plotësuar të gjitha kriteret e ak për punët e ngjashme është penalizuar me 55%. Përsa më sipër është e dallushme që kvo ka bërë vlerësimfavorizues për oe të caktuar duke mos respektuar kriteret e AK. Për këto arsye kërkojmë ë kvo të bëjë vlerësim real dhe pa favorizime duke i ulur pikët e dhëna nga kvo për oe e tjerë ekonomik Alko Impex General Contruction” sh.p.k., “2T” sh.p.k., “I.D.K. Konstruksion” sh.p.k.[..].

Përvoja në punë e kompanisë [0-20]

Sipas KVO vlerësimi për këtë kriter është:

Victoria Invest 9 pikë (45%)

2T 16 pikë (80%).

Alko Impex General Contruction” sh.p.k 20 pikë (100%)

“I.D.K. Konstruksion” sh.p.k. 10 pikë (50%)

Sipas procesverbalit të KVO për këtë kriter përcaktohet se vlerësimi për këtë kriter është bërë midis kompanive konkurrese.

Ju bëjmë me dije se kjo metodologji vlerësimi është në kundërshtim me dst dhe nuk ka asnjë bazë ligjore. Në LPP përcaktohet se vlerësimi i oe bëhet në bazë të dokumentacionit të secilit oe dhe në bazë të kriterëve për kualifikim. Në këtë rast AK nuk ka bërë asnjë përcaktim në dst që vlerësimi për këtë kriter do të bëhet midis kompanive që konkurrojnë në secilin lot. Është e padrejtë që shoqëria jonë të vlerësohet për këtë kriter në bazë të dokumentave të paraqitur nga oe të tjerë. Sepse në llogjikën tuaj fitues do të jetë shoqëria e cila ka hyrë me sa më shumë shoqëri të tjera si bashkim operatorësh ekonomik.

Shoqëria jonë ka paraqitur cv dhe referenca për punët e kryera në 10 vitet e fundit dhe kemi plotësuar kriterin e vendosur në dst 2.3.1. kapacitet teknik [...].

Dhe kjo nënkupton që plotësimi i këtij kriteri vlerësohet me 20 pikë, duke qënë se në dst nuk ka asnjë përcaktim tjetër.

KVO në këtë vlerësim nuk ka llogaritur kontratën e paraqitur me AK Drejtoria e Rjonit Qëndror nr. 12datë 09.01.2019 me objekt: Mirëmbajtje me performancë K/Sauk - Sanatorium, Sauk - Km 29 - rot. re Shijon - Ura e Zaranikës, Km22 - Qytezë Krrabë - Objekti X, Rotondo Sauk - Sauk i Vjetër, Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj, Vaqarr - Vishaj” K Baldushk 116.25 km kontrata 3 me afat 2 vjet e cila mbaron në datën 09.01.2021. Për të cilën kemi paraqitur kontratë situacion 1-18 fatura tatimore shitje për këtë kontratë kemi bërë kërkesë pranë DRQ për referencë, por nuk na kanë dhënë, të cilat janë të paraqitura në këtë procedurë tenderi.

Kjo kontratë +situcionet 1-18, dhe faturat tatimore të shitjes duhet të vlerësoheshin nga KVO pasi kjo kontratë ka situacione mujore. Madje dhe KPP në vendimet e saj e vlerëson paraqitjen e faturave tatimore të shitjes si të një vlerëshme me referencën e shërbimeve/punimeve.

Gjithashtu KVO nuk ka vlerësuar dhe situacionet mujore për shërbim pastrimi në të cilat ka një zë shërbimi "mirëmbajtje rrugore".

Ndërsa në shoqërinë "2T" sh.p.k. KVO i ka pranuar situacionet e pjesshme për kontratën e papërfunduar me ARRSH dhe BB me objekt mirëmbajtje dhe siguria rrugor bazuar në rezultate e cila përfundon në 2022.

Ju kërkoj që ti pranoni këto shërbime sipas kërkesës së mësipërme.

KVO në procesverbalin për këtë kriter ka shpjeguar se:

8 pikë do të vlerësohen punimet e ngjashme ndërtimi rikonstruksioni riveshje asfaltime rrugore.

12 pikë do të vlerësohen punime të ngjashme mirëmbajtje rrugore.

Theksojme se kjo ndarje e pikeve nuk është në përputhje me menyren e vleresimit të shprehur në DST.

Sipas kriterëve të dst OE duhet të paraqese pune të ngjashme me 30% të fondit limit, Per të cilën OE "Victoria Invest" ka paraqitur kontratat pune të ngjashme me vlerën 726,444,487 lekë për punime ndërtimi dhe në mirëmbajtje rrugore ka paraqitur në vlerën 50 353 736 lekë (kontrata me DRQ, periudha realizimit 31.12.2017) dhe kontrata me DRQ nr.12 date 09.01.2019 me situacione nr. 1-18 me vlere të realizuar dhe faturuar rreth 37 051 388 lekë, si dhe kontratat e shërbim pastrimit me, në të cilat ka edhe zë shërbimi "mirëmbajtje rrugore".

Nderkohe që kriteri sipas dst është: pune të ngjashme 30% e fondit limit, ekuivalent me 79,027,457 lekë, edhe se OE Victoria Invest ka paraqitur pune të ngjashme mbi 10-fishin e kërkesave të dst KVO për pune të ngjashme.

KVO e ka vlerësuar me 9 pike të ndara në 7 pike për punë ndërtimi dhe 2 pike për punë të ngjashme për mirëmbajtje. Me interpretimin e metodës së pikezimit sipas ndarjes së mesipërme duke i dhënë piket maksimale kompanive që kanë punë të ngjashme të mirëfillta në ndërtim dhe në mirëmbajtje ndërsa kompanitë të tjera duke përdorur metodën e pikezimit në raport me vlerat e punimeve të kompanive të tjera të paraqitur në këtë procedurë.

Ju theksojme se OE Victoria Invest ka paraqitur reference të punëve të ngjashme të mirëfillta në ndërtim rrugësh si dhe punë të ngjashme të mirëfillta në mirëmbajtje mbi vlerën 30% të fondit limit të kërkuar nga AK në kriteret, ku sipas kriterit të DST duhet të marrim pike maksimale 20. Përsa i përket metodës së përdorur të pikezimit në raport me vlerat e punimeve të ngjashme të kompanive të tjera të paraqitur në këtë procedurë, ju bejme me dije që kjo mënyrë nuk është në përputhje me kriteret e dst.

Për këto arsye ju kërkojmë që të vlerësohemi me piket maksimale 20, (dhe me llogaritjet përkatëse e sipas % dhe vlerës se ofertuar) për këtë kriter (Përvoja në punë të kompanisë).

(iii) Cilësia

[10-20]

Sipas KVO, vlerësimi për këtë kriter është:

Victoria Invest shpk 12 pike (60%)

2T shpk 16 pike (80%,)

Aiko Impex General Konstruksion dshh & Alko Impex Konstruksion shpk 20 pike (100%)

I.D.K. Konstruksion& 4A-M shpk 20 pike (100%)

Sipas procesverbalit të KVO, Victoria Invest shpk është penalizuar me 5 pike minus për metodologjinë dhe 3 pike minus në një mjet të llojit grejder është deklaruar në shtojcën e makinerive të objektit "Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i "Pallatit me Shigjeta" - rrethrotullimi "Shqiponja" Loti 3".

Penalizimi me 5 pike për metodologjinë konsistojnë si më poshtë vijon :

Pretendimi të KVO për mos qenien e qarte në shpjegimin e dy qendrave të mirembajtjes (pikat c mbeshtetjes dhe mirembajtjes PMM) në kuptimin e kantierëve që do të shërbejnë si pika ndërhyrjeje të domosdoshme. Që në vijim përshkruhet vetëm njëri, kantieri i Elbasanit.

Sqarojmë se në faqen 4 në figurën 2 është sqaruar vendodhja e dy qendrave operative PMM por për mos perseritjen e fjalëve, sqarimi është bërë në numrin shumë duke folur për të dy kantierët për faktin se që të dyja këto kantierë do të kenë të njëjten organizim.

Në lokacionet e percakjuara për qendra (kantiere) operative PMM punohet rrethorja, ndërtohen strukturat e perkohshme, sigurohen pajisjet e duhura, instalimet dhe infrastruktura informatike dhe telekomunikuese. Të gjitha këto përgatiten në përputhje me DST dhe specifikimet teknike.

Ju bëjmë me dije se metodologjia bëhet në bazë të specifikimeve teknike të dhëna nga autoriteti kontraktor, dhe nuk qendron pretendimi juaj që është kopje e nga materiali specifikime teknike. Pretendimi që në dokumentat e OE nuk ka asnjë dokument që evidenton planin e sigurimit teknik ju theksojmë se ky pretendim nuk është i saktë për arsye se në dokumentat e dorëzuara në mënyrë elektronike në dt.19.10.2020, "Plani për sigurimin teknik ndodhet në dokumentin me emër: Shendetit dhe Siguria Në Punë" me 26 flete ku shpjegohen masat e sigurimit teknik për proceset e punëve si dhe pajisjet që duhet të zoterojë çdo punonjës në kantier.

Për ky penalizim i KVO është padrejtë, Kërkojmë le hiqet ky penalizim.

Pretendimi të KVO se mungon "plani i manaxhimit të aksidenteve dhe ndihmes së shpejtë",

Ju theksojmë se plani për menaxhimin të aksidenteve është parashikuar në faqen nr.36 të dokumentit "Përshkrimi i Metodologjisë dhe plani i punës", ku janë të përshkruara metodologjia, skica plani pune të dorëzuar në mënyrë elektronike në dt.19.10.2020. Plani i ndihmes së shpejtë është parashtruar në faqen nr 17 të dokumentit "Përshkrimi i Metodologjisë dhe plani i punës", paragrafi , "Aktivitetet emergjente dhe mbrojtja nga zjarri" në të cilën është paraparë ndihma e shpejtë në rastet e : 1-Aksidenteve rrugore, 2-Rrjedhjes së materialeve të rrezikshme, 3-Bartjes së zjarrit nga zjarret malore dhe fushore përgjatë vijës së akteve rrugore 4- demtimeve të mundshme në udhëtim dhe Akteve të qellimshme. Në KVO i referohet ndimes së shpejtë mjekësore theksojmë se në dokumentat standarte të tenderit nuk ka asnjë kërkesë që operatori ekonomik duhet të sigurojë pajisje dhe staf të specializuar për të ofruar shërbim të ndihmes së shpejtë mjekësore në raste aksidentesh. Për KVO ka bërë vlerësim në bazë të kërkesave të paparaqitura nga AK në dst, KVO nuk mund të penalizojë për këtë fakt, për shkak të një kërkesë të pakërkuar në dst, Për ky penalizim i KVO është i padrejtë. Kërkojmë të hiqet ky penalizim.

Pretendimi të KVO për planin e menaxhimit social dhe mjedisorë

Theksojmë se në dokumentat standarte të tenderit nuk ka asnjë kërkesë që operatori ekonomik duhet të paraqesë planin për menaxhimin social dhe mjedisor. Përse nuk është në kriteret kualifikuese të tenderit, nuk ka si të merret si pike vlerësimi dhe penalizim.

Për ky penalizim i KVO është i padrejtë. Kërkojmë të hiqet ky penalizim.

Pretendimi për planin e menaxhimit të trafikut

Pretendimi i KVO se plani i menaxhimit të trafikut nuk është i qarte apo nuk jep një

panorama te qarte te manaxhimit të trafikut, theksojme se ky plan eshte i sqaruar ne materialin me titull "Pershkrimi i Metodologjise dhe plani i punes" nga faqja 18 deri 36 ne perputhje me specifikimet teknike te ketij objekti.

Persa me siper sqarojme komisionin e vleresimit te ofertave qe nuk pajtohem me penalizimin e dhene per arsyet e me siperme. Ju kerkojme te beni rikontrollin e dokumentave si dhe te beni rivleresim te pikeve.

Pra ky penalizim i KVO eshte padrejte. Kerkojme të hiqet ky penalizim.

Te gjitha materialet e paraqitura ne tender jane ne gjuhe të kuptueshme.

Per te gjitha argumentat e mesiperme, kerkojme te hiqet keto penalizime dhe kerkojme piket maksimale per kete kriter.

Në lidhje me pretendimin tuaj se: nje pjesë e mjeteve per te cilat OE ka paraqitur deklarate mosangazhimi, rezulton te jetë e angazhuar ne kontratën e lidhur me ARRSH, per ndertimin e lotit 3 te Unazës se Tiranës, dhe penalizim me 3 pike minus per ketë kriter, ju sqarojme si me poshte vijon :

se pari eshte vetem nje mjet i llojit grejder, (i cili nuk punon gjithe kohes per te gjithë afatin e kontrates, pasi eshte mjet qe punon vetëm per nivelimin e shtreses se stabilizantit te rrugës para asfaltimit), dhe nuk jane nje pjese e mjeteve, sic pretendoni juve. Pra ka perdorim te pjesshem dhe nuk eshte mjet qe punon gjithe kohes se kontrates si kamion, eskavator, kamioncina, rrula, autobetoniere, autobot uji etj.

Ky mjet eshte tek kontrata me ARRSH menr.7734/5 date 02.11.2018 me AFAT 2 VJET.

Pra ne kete moment kjo kontrate duhej të perfundonte, dhe mjete grejder do te kishte mbaruar procesin e punes se vet ne kohen e hapjes se ofertave per proceduren objekt ankese.

Per fajin e ARRSH dhe jo te shoqerise tone. ne daten e hapjes se ofertave faza e pare, (ne te cilen dorezohen edhe gjithe dokumentacioni i kërkuara per mjetet, dokument pronesie ose qiraje) nuk na eshte dhene Leja per Fillimin e Punimeve po nga vetë Institucioni Juaj.

Ju bejme me dije se mjetet e kerkuara ne kriteret per kualifikim jane paraqitur qe ne fazen e pare te dates 7 gusht 2020, periudhe ne te cilen kjo kontrate me ARRSH REF-84983-09-07-2018 "Rehabilitim i segmentit rrugor. mbikalimi i Pallatit me Shigjeta .. – rrethrotullimi "Shqiponja .. Loti 3" nuk kishte filluar akoma punimet per faj te AK-ARRSH e cila nuk na kishte dhene "Lejen per Fillimin e Punimeve". keto mjete te paraqitura qe ne fazen e pare te dates 7 gusht 2020 nuk mund te ndryshohen, sepse parakualifikimi është bërë pikërisht mbi bazen e ketyre mjeteve. Këto mjete nuk quhen të angazhuara deri ne momentin qe kontrata eshte REF-84983- 09-07-2018 nr.7734/5 date 02.11.2018 nuk ka filluar punimet per arsyen e siperpermendur. Dhe akoma nuk eshte lidhur shtesa afatit e kontrates.

Per me teper, ne dst e procedures se REF-84983-09--07-2018 "Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i "Pallatit me Shigjeta" - rrethrotullimi "Shqiponja" Loti 3" me date 17.10.2018, ne kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.3. 7 mjetet, jane kerkuar 2 mjete grejder. Ketu Victoria Invest shpk ka marrë pjese si bashkim i perkohshem i shoqerive, dhe shoqeria tjeter (e cila eshte kryesuese) ka paraqitur 2 mjete grejder (deklarate doganore R 2341 dhe R 421, ndersa Victoria Invest shpk ka paraqitur 2 mjet grejder (deklarate doganore R 2005 dhe R 12679).

Pra ky mjet qe pretendoni juve se është i angazhuar në kontraten tjeter, eshte i teper/ te ajo kontrate. (bashkangjitur keni shtojcat e makinerive te dy shoqerive per kontraten nr.7734/5 date 02. 11.2018)

Pra ky pretendim i juaji nuk qendron.

Madje edhe KPP si organ epror ne fushen e prokurimeve, e quan te padrejte kriterin e mosangazhimit te mjeteve ne kontrata te tjera, Shif Vendim KPP 351/2020 te dates 03.09.2020, per proceduren "kryerja e sherbimit te pastrimit ne qytetin e Elbasanit" ku ankues eshte Alko Impex General Construction, i cili ankohet qe kriteri i vendosur nga AK "mjetet e paraqitura ne tender nuk jane te angazhuara ne kontrate tjeter... "eshte i padrejte dhe i paligjshëm. Dhe KPP me arsyetimin e saj pranon ankesen, dhe e gjykon kriterin e vendosur nga AK "mjetet e paraqitura ne tender nuk jane te angazhuara ne kontrate tjeter.... " ne kundeshitim me legjislacionin per prokurimet publike. KPP ne kete vendim shprehet referojmë vendimin[...]

Kerkojme qe te beni rivleresim te pikeve per kete kriter per shoqerine Victoria Invest shpk, dhe te vleresohemi me piket maksimale 20, (dhe me llogaritjet përkatëse sipas perqindjes dhe vleres se ofertuar) per kete kriter (per kriterin "cilësia").

Gjithashtu ju bëjmë me dije se nga ana KVO duhej te behej edhe shqyrtimi i angazhimit te mjeteve te operatoreve te tjere per të cilat nuk keni bere asnje verifikim, ndonese kane disa here me shume kontrata ne proces se shoqeria jone. Po ju paraqesirm faktet :

Shoqeria 2T shpk ne kete procedure objekt ankese (Lori 4: REF-65733-07-16-2020) ka paraqitur 3 kamioncina me targe AA563RD, AA564RD, AA56SRD me mase maksimale te autorizuar 3,5 ton, aq sa kerkohej ne dst pika 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim.

Ju bejme me dije se keto 3 kamioncina te paraqitura ne kete procedure prokurimi, shoqeria 2T shpk i ka dhene me kontratë qiraje noteriale nr.rep.8745 nr.kol.6855 date 20.09.2017, shoqerise Alko Impex General Construction nipt K91326028J per objektin "Shërbirni i pastrimit të Qytetit te Tiranës Zona III". ju bejme me dije se Alko Impex General Construction ka lidhur kontratë per kete objekt me bashkine Tirane me date te lidhjes se kontrates: 12.03.2018. Afati 3 vjet. (referuar buletin te Agjencise Prokurimit Publik) . pra keto mjete jane per sherbimin e pastrimit te Qytetit te Tiranës Zona III deri ne date 11.03.2021.

Pra mjetet nuk jane te disponueshme nga 2T shpk per prokurimin e mirembajtjes objekt ankese Loti 4: REF-65733-07-16-2020 "Mirembajtje me performance K/Sauk - Sanatorium, Sauk - Km 29 - rot. re Shijon - Ura e Zaranikes, Km22 - Qyteze Krrabe - Objckti X, Rotondo Sauk - Sauk i Vjeter, Ura e Farkcs - Baldushk- Mustafa Kocaj, Vaqarr - Vishaj"

Bashkangjitur keni dokumentacionin provues : kontrate qeraje noteriale nr.rep.8745 nr.kol.6855 date 20.09.2017, dhe shtojcen e deklarimit të mjeteve nga Alko Impex General Construction.

Ju kerkojme qe te kryeni verifikimet perkatëse te mjeteve kamioncina te paraqitur nga 2T shpk ne kete procedure, dhe te beni penalizimin perkates, sic vepruat me Victoria Invest shpk (penalizirn 3 pike per nje mjet).

Shoqeria 2T shpk ka ne proces si nenkontraktor i miratuar me ARRSH : Projekti i mirembajtjes dhe sigurise rrugore bazuar ne rezultate, Lot 3- Kontrata C - Rajoni Qender-Jug-Lindje i Shqiperisc: Fier, Elbasan, dhe Korce, RRMSP/CË/2015/3, me afat perfundimi vitin 2022 (te cilën e ka listuar KVO edhe ne listen e kontratave të realizuara nga 2T shpk për llogaritjen e pikeve te kriteri - Pervoja ne pune e kompanise ndonese është kontrate e pa-perfunduar).

Shoqeria 2T shpk, ne permbushje te kriterit kualifikues te dst :

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine

e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Kjo shoqeri ka paraqitur ne kete procedure vertetim per pagesen e taksave dhe tarifave vendore ne qytetin e Tiranes, dhe vendet e tjera sipas ekstraktit te QKB, dhc dklaraten perkatese.

Per bashkine e Elbasanit ka paguar taksat dhe detyrimet vendore deri ne 18.09.2020, dhe nuk ka paguar per vitin 2020. Duke qënë se është duke kryer punime ne territorin e kesaj bashkie sipas kontratës me ARRSH dhe BB, dhe nuk ka shlyer detyrimet perkatese te taksave dhe tarifave vendore, ju kerkojme qe te merrni penalizimin perkates. Ashtu si po veproni edhe me shoqerine tone Victoria Invest shpk.

Bazuar ne piken 3 te nenit 43 re ligjit nr.9723 date 3.5.2007 "Per regjistrim tregtar" percaktohet se pervec sa parashikohet ne piken 1 te ketij neni, subjekti duhet te regjistroje dhe te depozitoje aktet perkatese, si me poshte. .. d)vendet e tjera te ushtrimit te veprimtarise te ndryshem nga selia...".

dhe referuar ligjit 9920 dt. 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" duhej te paguante taksat dhe detyrimet vendore ndaj bashkise Elbasan per vitin 2020.

Shoqëria 2 T shpk ka në proces si nënkontraktor i miratuar me ARRSH : Projekti i mirëmbajtjes dhe sigurise rrugore bazuar ne rezultate, Lot 3- Kontrata C Rajoni Qender-Jug-Lindje i Shqiperise: Fier, Elbasan, dhe Korce, RRMSP/CE l2015/3. me afat perfundimi vitin 2022 (te cilën eka listuar KVO edhe ne listen e kontratave te realizuara nga 2T shpk per llogaritjen e pikëve te kriteri - Pervoja ne pune e kompanise, ndonese eshte kontrate e pa-perfunduar)

KVO vendos per kete kontrate te pa-përfunduar që 2T shpk të vlerësohet me 16 pike, ndërsa shoqërise tone nuk i llogarit te vleresimi kontraten e mirembajtjes rrugore nr.12 date 09.01.2019 me afat 2 vjet lidhur me DRQ Tirane (aksi rrugor objekt ankese) .

Shoqeria Alko Impex Construction shpk nipt K91628013D ka paraqitur ne kete procedure REF-65733-07-16-2020, mjetet me targe AA39JZI, AA785YT, AA875XI, AA392ZI, AA874XI, AA873XI, AA634YP.

Ju bejme me dije se keto mjete Alko Impex Construction shpk nipt K91628013D i ka dhene me kontrale qeraje noteriale nr.rep.5908 nr.Kol 1726/1 date 26.08.2020 shoqerise tjeter Alko Impex General Construction dshh nipt K913260281 per "Pastrimi i qytetit dhe largimi i mbetjeve" me AK-Bashkia Sarande, per te cilen eshte shpallur fitues.

Sipas kësaj kontrate noteriale mjetet jepen me qera deri ne perfundim te punimeve, dhe janë me keto spccifikime mjet teknologjik (per mbeturina) AA39IZI, mjet teknologjik (per mbeturina) AA785YT, mjet teknologjik (per mbeturina) AA875XI, mjet teknologjik (per mbeturina) AA392ZI, mjet teknologjik (per mbeturina) AA874XI, mjet transportues për kontenieret AA873XI, autobot uji AA634YP.

Fillimisht ju kerkojme qe te kryeni verifikimet perkatese per llojin e mjeteve te paraqitura, pasi jane paraqitur me funksion tjeter (dmth mjetet ATV qe jane mjete teknologjike mbeturinash, jane paraqitur si autobot uji) ne procedurat e prokurimit te ARRSH me "Mirembajtje me performance të rrugeve Rajoni Qendror" (e ndare ne 10 Lote), me date hapje 7.8.2020 (faza e pare) dhe faza e dyte, te procedura "Mirembajtje me performancë të rrugeve Rajoni Verior (e ndare ne 14 Lote), "Mirembajtje me performance të rrugeve Rajoni Jugor" te zhvilluar nga ARRSH.

Pra mjetet nuk janë te disponueshme nga Alko Impex Construction shpk nipt K.916280130 per prokurimin e mirëmbajtjes objekt ankese Loti 4: REF-65733-07-16-2020 "Mirembajtje

me performance K/Sauk - Sanatorium, Sauk - Km 29 - rot. re Shijon - Ura e Zaranikes, Km22 - Qyteze Krrabe - Objekti X, Rotondo Sauk - Sauk i Vjcter, Ura e Farkes - Baldushk - Mustafa Kocaj, Vaqarr - Vishaj " .

Bashkangjitur keni dokumentacionin provues, bashke me mjetet dhe fotot .

Shoqëria Alko Impex General Construction dshh nipt K913260281, ka paraqitur ne kete procedure mjetet me targe: AA863SD Autobot uji, M864SD makine teknologjike mbeturinash, AA86SSD makinë teknologjike mbeturinash , AA87 I 4SD makine teknologjike mbeturinash.

Te cilat jane te angazhuara per objektin "Sherbimi i pastrimit te Qytetit te Tiranes Zona III" me bashkine Tirane me date te lidhjes se kontrates: 12.03.2018, afati 3 vjet. (referuar buletinit te Agjencise Prokurimit Publik), pra keto mjete jane per sherbimin e pastrimit te Qytetit te Tiranes Zona III deri ne date 11.03.2021. Fillimisht ju kerkojme qe te kryeni verifikimet perkatese per llojin e mjeteve te paraqitura, pasi jane paraqitur me funksion tjetër (dmth mjetet ATV qe jane mjete teknologjike mbeturinash, jane paraqitur si autobot uji) ne procedurat e prokurirnit te ARRSH me "Mirembajtje me performance të rrugeve Rajoni Qendror" (e ndare ne 10 Lote), me date hapje 7.8.2020 (faza e pare) dhe faza e dyte, te procedura "Mirembajtje me performance të rrugeve Rajoni Verior" (e ndare ne 14 Lote), "Mirembajtjen e performance të rrugeve Rajoni Jugor" te zhvilluar nga ARRSH.

Ju kerkojme qe te verifikoni mjetet e Alko Impex General Construction dshh nipt K913260281, te paraqitura ne kete procedure, konkretisht mjetet me targe : AA 198TI, AA87SXM, AGMT47, AGMT48 te cilat jane ne perdorim aktualisht ne kontratat e pastrimit me Bashkine Devoll, Tirane, Kavaje (shif vendim KPP 217/2020 , te cilin e keni bashkangjitur, e keni edhe te publikuar ne faqen e KPP ne internet keto mjete deklarohen si autofshesa, kamione transportues, dhe si autobote uji, ne AK të ndryshem.

Mjeti me targa AA865SD i deklaruar ne deklaraten e mjeteve te paraqitur në Bashkine Vlore, me emertimin "kamion pastrimi", rezulton se është deklaruar për tu përdorur ne Bashkine Kavaje, rezulton se është deklaruar per tu perdorur si makine teknologjike në Bashkine Devoll, si dhe rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si kompatator ne Bashkinë Tirane.

Mjeti me targa AA871 SD i deklaruar në deklaraten e mjeteve te paraqitur në Bashkine Vlore, me emërtimin "kamion pastrimi", rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur ne Bashkine Kavaje, rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si makine teknologjike në Bashkine Devoll, si dhe rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si kompatator ne Bashkine Tirane.

Mjeti me targa AA 198TI me nr.shasie VF644ACA0000J3207 i deklaruar si "Autofshese" ne Bashkine Vlore, rezulton se eshte deklaruar per tu perdorur si kamion 7.5 - 18 ton ne Bashkine Kavaje, dhe per tu perdorur si Autobot ne Bashkine Tirane.

Keto vertetohen ne vendim KPP 217/2020, te cilin e keni bashkangjitur.

Shoqeria Alko Impex General Construction dshh nipt K913260281, ne permbushje te kriterit kualifikues te dst :

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, "PerProkurimin Publik".

Kjo shoqeri ka paraqitur ne kete procedure vertetim per pagesen e taksave dhc tarifave vendore ne qytetin e Tiranes, dhe deklaraten perkatëse.

Ju bejme me dije se kjo shoqeri pervec adreses se percaktuar ne QKB "rruga Reshit Petrela, kompleksi Usluga, kati 8, Tirane" ushtron veprimtari edhe ne adresen e "Ish Parku Automjeteve Kombinat, Rruga e Fabrikes se Qelqit, Tirane" sipas deklarimit qe ka bere ne licencen III.2.B me date 10.3.2016, të leshuar nga QKB. Ne vertetimin e pagesës së taksave vendore te leshuar nga Bashkia Tirane, vereni se pagesa per taksat dhe tarifate per detyrimet vendore eshte vetem per seline e shoqerise, dhe jo per vendin tjeter te ushtrimit të aktivitetit.

Shoqeria jone i ka derguar shkrese bashkise tirane ku i kerkon: ne rast se shoqeria ushtron aktivitet brenda territorit të bashkisë Tirane, ne vend tjeter te ndryshem nga selia, atehere vertetirni i taksave dhe tarifave vendore eshte i mjaftueshem ??

Bashkia Tirane na kthen pergjigje me shkresen nr. V-8087/1 prot date 16.10.2020, ku na thote: per cdo adrese te re brenda territorit te bashkise Tirane, do te llogariten taksa dhe tarifa vendore te tjera pra shoqeria Alko Impex General Construction dshh nipt K91326028I nuk ka paguar taksat dhe tarifate vendore ndaj bashkise TIRANE.

Ju kerkojme qe te merrni penalizirnin perkates. Ashtu si po veproni edhe me shoqërinë tone Victoria Invest shpk

BOE "Alko Impex General Construction dshh & Alko Impex Construction shpk" ka paraqitur në këte procedure dhe ne te gjitha procedurat e tjera te :

"Mirëmbajtje me performance te rrugeve Rajoni Qendror" (e ndare ne 10 Lote) Mirëmbajtje me performance te rrugeve e Rajoni Verior" (e ndarë ne 14 Lote) "Mirembajtje me performance te rrugeve Rajoni Jugor" (e ndare ne 13 Lote) Ka paraqitur te njejtat mjete, dhe ARRSH duhej ta s'kualifikonte kete OE.

Ne piken 2.3.10 te kriterëve per kualifikim kerkohej : kontrata e qerases e cila duhet te perfshije Objektin përkatës dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates/kontratave.

Ne kontratat e qerases se mjeteve të paraqitura në keto procedura, nuk eshte pershkruar objekti perkates i tenderit, duke qene ne kundërshtim me kriterin kualifikues. Gjithashtu ky OE ka paraqitur 10 punonjes manovratorë sipas kriteri kualifikues 2.3.6 të dst, por ARRSH e ka kualifikuar ne disa lote (ne disa procedura) dhe është ne pritje te shpalljes fitues dhe lidhjes se kontrates, por po vonoheni qellimisht per lidhjen e kontratave.

Pra ARRSH ka kualifikuar në kundërshtim me LPP dhe kriteret e dst. kete OE qe po me te njejtet 10 manovratorë dhe staf teknik inxhinierik, ka fituar 2 lote në Rajonin Verior, 2 lote ne Rajonin Qendror, dhe 2 lote ne Rajonin Jugor. Ndersa shoqerine tone e penalizon per l grejder i deklaruar i tepert te Lot 3 Unaza Tirane, kontratë e cila ka qene e pezulluar nga ARRSH ne mornentin e hapjes ofertave per kete procedure objekt ankese.

Gjithashtu ju bejme me dije se ne baze te procesverbalit qe na beri me dije KVO, anetari i BOE Alko Impex Construction shpk nuk ka paraqitur në tender asnjë kontrate mirembajtje rrugore, pasi te gjitha kontratat jane paraqitur nga anëtari tjeter i BOE Alko Impex General Construction dshh. Pra nga ana e AK eshte kualifikuar nje bashkim operatorësh dhe vleresuar me piket maksimale 20, megjithese njeri anetar nuk ka paraqit asnje kontrate mirembajtje rrugore.

Keto veprime te KVO shkojne deri ne shperdorim detyre ...

KVO duhej të bënte verifikim të angazhimit te mjeteve edhe per shoqerite e tjera qe kane paraqitur ofertat ne kete procedure, duke verikuar angazhimin e mjeteve ne kontratat qe

kane ne proces, duke iu referuar edhe buletin te app, dhe jo te verifikonte vetem shoqerine tone ne menyre selektive.

Po ju listojme nje pjese te kontratave qe kane ne proces keta operatore ekonomik Shoqeria 2T shpk ka lidhur kontrate me bashkine Lezhe me objekt "NDRICIMI I QYTETIT ME SISTEMIN LED". (buletini app nr.26 date 11 maj 2020).

Kontrate me Bashkinë Belsh me objekt "Linja kryesore per furnizimin me ujë dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit per qytetin e Belshit" Faza III", me vlere 474 517 615 leke (katerqind e shtatedhjete e kater milion e peseqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashteqind e pesëmbëdhjetë) lekë p TVSH. Ne kete kontrate pjesa me e madhe e mjeteve jane te njejta me procedure objekt ankimi Loti 4: REF-65733-07-16-2020. (data lidhjes kontrates 2.6.2020, buletini app nr.41 date 6 korrik 2020)

Shoqeria 2T shpk ka ne proces si nënkontraktor i miratuar me ARRSH : Projekti i mirëmbajtjes dhe sigurise rrugore bazuar ne ne rezultate, Lot 3- Kontrata C - Rajoni Qender-Jug-Lindje i Shqiperise: Fier, Elbasan, dhe Korce, RRMSP/CË/2015/3.

Shoqeria Alko Irnpex General Construction dshh & Aiko Impex Construction" me ARRSH - Alko Impex General Construction dshh & Konstruksion & Alko Impex General Construction" objekti: Loti VI: "Mirembajtje me performance Shirgjan - Kacivel - Drize, Mjebes - Uzine, Elbasan - Gjinar, Gramsh - Kodovjat - Molle Grabove, Drize - Porocan", REF-65715-07-16-2020 Vlera: 301.101.555 Leke (referuar buletin te Agjencise Prokurimit Publik) Me BASHKIA DEVOLL Objekti "Sherbimi i pastrimit per Bashkine Devoll", Vlera totale perfundimtare e kontrates eshte: 98 993 589 (nentedhjete e tete milion e nenteqind e nentedhjete e tre mije e pesëqind e tetcdhjete e nente) Lekë pa tvsh, 118, 792,306 (nje qind e tetembëdhjete milion e shateqind e nentedhjete e dy mije e treqind e gjashte) lekë me t.v.sh., data e lidhjes se Kontrates: 18.01.2018 Afati kontrates 3 vjet. (referuar buletin te Agjencise Prokurimit Publik)

Me bashkine Librazhd "Sherbimi i Pastrimit dhe Menaxhimit te Mbetjeve Urbane ne Bashkine Librazhd". Numri i references se procedures/lotit:REF-61912-06-18-2020 Vlera 119 565 169 lekë pa tvsh vlerë e përlllogaritur për 52 muaj. Data e lidhje së kontratës 31.08.2020 (referuar buletin të APP-SË).

Me Bashkinë Kavajë "Shërbimi i pastrimit të njësisë administrative Golem" Numri i references se procedures/lotit: REF-52946--03-04-2020, Fondi limit: 255,581,960 (dyqind e pesedhjete e pese milion e peseqind e tetedhjete e nje mije e nenteqind e gjashtëdhjete) leke pa tvsh. Data e lidhjes se kontrates: 19/06/2020 (referuar buletin te Agjencise Prokurimit Publik).

Me Bashkinë Shkodër Shërbimi i Pastrimit Qytetit Zona Jugore A" Objekti : "Sberbimi i Pastrimit Qytetit Zona Veriore B" Objekti: "Sherbimi i Pastrimit Qyretir Zona Jugore A" REF-57016-04-28-2020, vlera 22,120,547 leke pa TVSH, - Afati i perfundimit te sherbimit: 4(kater) muaj. "Sherbimi i Pastrimit Qytetit Zona Veriore B" , REF-57015-04-28-2020, Fondi limit: 18,652,476 leke pa TVSH. - Afati i perfundimit te sherbimit: 4(katër) muaj. "Sherbimi i pastrimit per Bashkine Shkoder Zona Lindore".REF-64315-07-07-2020 Vlera 48,257,718 leke pa tvsh. Data e lidhjes se kontrates 09.10.2020. (referuar buletin të Agjencise Prokurimit Publik).

Me bashkine Tirane "Sherbimi i Pastrimit te Zones Tirana III" vlera 473 765 974 lek pa tvsh (të reja). Afati 3 vjet. Data e lidhjes se kontrates: 12.03.2018 (referuar buletin të Agjencisë të Prokurimit Publik)

Me bashkinë Tirane "ndertim i godinës TIP në RSU Nr.3" vlcra 306.499.751 lekë pa tvsh (te reja). Data e lidhjes se kontrates: 27.10.2020. (referuar buletinit te Agjencise Prokurimit Publik).

I bejme me dije KSHA se ARRSH se diferenca financiare midis shoqerise tone Victoria Invest shpk dhe oe te kualifikuar i pari Alko Impex General Konstruktion dshh & Alko Impex Konstruktion shpk eshte 42,154,086 leke te reja, nderkohe qe ky aks rrugor po mirembahet nga ana jone me kontraten aktuale per vleren 52,870,698 leke per 2 vjet. Dhe KVO ben vleresime subjektive duke kualifikuar oe me te shtrenjtë në ofertë.

Perfundimisht i kerkojme AK qe: te beje rivleresim te pikeve sipas objektit te ankeses (dhe me llogaritjet perkatese sipas perqindjes dhe vleres se ofertuar) duke na dhene 20 pike per kriterin "Pervoja ne pune e kompanise" (dhe me llogaritjet perkatese sipas perqindjes dhe vleres se ofertuar)

20 pike per kriterin "cilesia" (dhe me llogaritjet perkatese sipas perqindjes dhe vleres se ofertuar)

Si dhe te beni rivleresim te pikeve per 2 operatoret e tjere ekonomik 2T shpk dhe Alko Impex General Konstruktion dshh & Alko Impex Konstruktion shpk, duke ulur piket sipas parashtrimeve të mësipërme qe ju kemi bere.

Bashkangjitur keni :

1. Kontrate nr.12prot date 9.1.2019 lidhur me DRQ Tiranë + situacione1-18+ fatura tatimore te situacioneve
2. Referenca sherbim pastrimi per Victoria Invest shpk leshuar nga Bashkia Elbasan dhe Bashkia Tirane.
3. Dst REF-84983-09-07-2018 "Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i "Pallatit me Shigjeta" - rrethrotullimi "Shqiponja" Loti 3"
4. Kontrate nr.7734/5 date 12.11.2018
5. shtojca 10 Mbi disponimin e makinerive" Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i "Pallatit me Shigjcta" - rrethrotullimi "Shqiponja" Loti 3 - Victoria Invest SHPK
6. shtojca10 Mbi disponimin c makinerive" Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i "Pallatit me Shigjeta" - rrethrotullimi "Shqiponja" Loti 3 - Victoria Invest International shpk.
7. Kerkese nr. 136 prot dt. 7.10.2020 Victoria Invest + kthim pergjigje Bashkia Tirane dt.16.10.2020 nr.V-8087/1prot
8. Licence QKL kodi III.2.B date 10.03.2016 +akt miratirni Alko Impex General Construction
9. Shtojce mbi disponimin e makinerive Alko Impex General Construction per objektin "Sherbim pastrimit te zones Tirana III"
10. Kontrate qeraje nr.rep.8745 nr.kol.6855 date 20.09.2017.
11. Buletini app nr.11 date 19 mars 2018
12. Vendim KPP 351/2020 date 03.09.2020
13. Shtojce mbi disponimin e makinerive Alko Impex General Construction per objektin "Pastrimi i qytetit dhe largimi i mbetjeve"
14. Buletini app nr.101 date 16 nentor 2020.
15. Kontrate qeraje nr.rep.5908 nr.kol.1726 date 26.08.2020
16. buletine te app
17. procesverbali KVO nr.5 date 12.10.2020, dhene nga KVO ne faqen e app te shoqerise tone.
18. Pershkrimi i metodologjise dhe plani i punes - Victoria Invest shpk per Loti 4: REF- 65733-07-16-2020

19. Metodologji e punimeve rutine dhe punirneve te rehabilitimit- Victoria Invest shpk per Loti 4: REF-65733-07-16-2020
20. Plani dinamik dhe grafiku punimeve dhe plani mobilizimit te makinerise - Victoria Invest shpk per Loti 4: REF-65733-07-16-2020
21. Plani i menaxhimit te cilësisë- Victoria Invest shpk per Loti 4: REF-65733-07-16-2020
22. Shendeti dhe siguria ne pune - Victoria Invest shpk per Loti 4: REF-65733-07-16-2020
[....]

II.6. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimues “Victoria Invest” sh.p.k., me anë të shkresës nr.8945/2prot., datë 23.11.2020, duke mos e pranuar atë, me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

[...]Arsyetoj me :

III.1. Lidhur me pretendimin e “Victoria Invest” sh.p.k me kerkesen per piket lidhur me oferten: [...] Menyra e vleresimit nuk është bërë në përputhje me dst qe OE me i shtrenjte te vleresohet me piket minimale. Prondaj kerkojme rishikim te vleresimit per operatoret e tjere ekonomik, duke i ulur piket e dhena nga KVO [.....], Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses veren se vleresimi i KVO lidhur me oferten

eshte i drejtë pasi e ka vleresuar me 60 pike ose 100% te pikeve lidhur me kriterin financiar operatorin Victoria Invest shpk, ndersa per ofertat e operatoreve te tjere ka llogaritur piket sipas formules se meposhteme. Me konkretisht:

OE “2T” sh.p.k.

oferta2 = Oferta minimale/Oferta e radhës x Treguesi i ofertës = (181127041/199614567.2)x60=54.4 pikë oferte

BOE Alko Impex General Konstruksion dshh & Alko Impex Konstruksion shpk

Poferta3 = Oferta minimale/Oferta e radhës x Treguesi i ofertës =(181127041/223281127.8)x 60 = 48.7 pikë oferte

BOE IDK Konstruksion & 4 A-M shpk

Poferta3 = Oferta minimale/Oferta e radhës x Treguesi i ofertës

(181127041/236705563.2)x60=45.9 pikë oferte.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi vlerësimin me pikë për përvojën me punë të ngjashme të kompanisë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se nga oe “Victoria Invest” shpk është paraqitur dokumentacion në lidhje me punët e ngjashme të kërkuar në dst dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara.

Komisioni gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat që kanë si kriter të përzgjedhjes së fituesit ofertën ekonomikisht më të favorshme duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të Prokurimit publik është e tillë që cdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave sqaron se vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave brenda diapazonit me pikë të përcaktuarnë dokumentat e tenderit por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim nuk dduhet të jetë subjektiv por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesmarrës në

procedurën e prokurimit. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar me 9 pikë operatorin ekonomik ankimues lidhur me këtë kriter duke mos vlerësuar as me minimumin e pikëve dhe as me maksimumin e tyre. Komisioni i shqyrtimit të Ankesave gjykon se vlerësimi është i matshëm në kushte kur niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar eksperiencat e mëparshme të realizuara. Përsa më sipër referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ankimues lidhur me përvojën në punë të kompanisë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon si më posht vijon.

Nga njohja me dokumentacionin e tenderit dhe konkretisht me preventivin limit dhe nevoja për të bërë një ndarje të drejtë në pikëzim (për ti dhënë një peshë të caktuar) përvojës së ngjashme në rastin kur kemi operatorë që kanë paraqitur si të tilla edhe kontrata në ndërtim rikonstruksion riveshje asfaltim rrugë edhe kontrata të mirëfillta mirëmbajtje (e përdorur për të siguruar një pjesmarrje më të gjerë në tender), rezulton që punimet e rehabilitimit nuk kalojnë kufirin prej 40% të preventivit limit. Nisur nga kjo rezulton që pesha e përvojës së ngjashme në rastin kur si e tillë paraqiten kontrata nëndërtim rikonstruksion riveshje asfaltim rrugë është :

8 pikë për punë të ngjashme ndërtim rikonstruksion riveshje asfaltim rrugë dhe 12 pikë për punë të ngjashme mirëmbajtje rrugë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve konstatohet se të katër konkurrentët në këtë procedurë prokurimi kanë përvojë në mirëmbajtjen rikonstruksionin dhe ndërtimin e rrugëve. Referuar procesverbalit të KVO-së lidhur me pikëzimin për këtë kriter KSHA vëren se pikëzimi është bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues. Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për njohje si përvojë të ngjashme e kontratave të shërbim pastrimit me faktin se në to ka zëra mirëmbajtjeje rrugore nuk qëndron pasi këto lloj kontratash nuk kanë të bëjnë me riparimin e rrugëve shtresave asfaltike etj por vetëm me fshirjen e tyre dhe largimin e mbeturinave dhe mbetjeje urbane. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe me operatorët e tjerë konkurrues për të cilët nuk janë marrë të mirëqëna kontratat e shërbim pastrimit.

Pretendimi i operatorit ankimues lidhur me mosmarrjen parasysh të kontratës në vazhdim nuk qëndron pasi në dst kërkohet që : “Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punët e realizuara në formë CV shoqëruar me vërtetim punimesh të kryera në 10 vitet e fundit”. Pikërisht vërtetimi i punimeve është një dokument i cili mbart në vetvete kuptimin e realizimit me sukses të një kontrate të caktuar. Thënë kjo, paraqitja e situacioneve dhe faturave të një kontrate të papërfunduar nuk përbën me doemos realizimin me sukses të saj. Ndërsa lidhur me pretendimin se nuk është përdorur i njëjti standart me “2T” sh.p.k. KSHA vëren se në rastin konkret në kontratën e paraqitur nga ky operator ekonomik rezulton që të jetë nënkontraktor i operatorit kryesor “Raëafed AI Torok Contracting Establishment” i cili sipas nenit 61 të LPP pika 4 ka përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit kontraktor për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij/saj dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi vlerësimin me pikë për treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementët e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik përse i përket metodave të përdorura personelit kryesor disponueshmërisë së pajisjeve kryesore organizimi i sitit siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit grafikut të punimeve dhe cdo aktiviteti tjetër sic mund të përcaktohet nga punëdhënësi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se operatori ekonomik ankimues ka pasur në

dispozicion kohën e mjaftueshme për të përgatitur ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Pavarësisht kësaj konstatohet se operatori ankimues për plotësimin e kriterit lidhur me mjetin Grejder ka paraqitur të njëtin mjet sikurse në kontratën me objekt : Loti 3 të Unazës së Tiranës, ky objekt pavarësisht se nuk ka filluar punimet nuk rezulton të jetë i anuluar nga autoriteti kontraktor. Pra rezulton që ky operator të ketë bërë deklaratë të rreme lidhur me disponueshmërinë e mjeteve. Për këtë arsye pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se procesi i pikëzimit në procedurat që kanë si kriter të përzgjedhjes së fituesit ofertën ekonomikisht më të favorshme duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të Prokurimit publik është e tillë që cdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave sqaron se vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave brenda diapazonit me pikë të përcaktuarnë dokumentat e tenderit por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim nuk duhet të jetë subjektiv por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit. Komisioni i shqyrtimit të Ankesave gjykon se vlerësimi është i matshëm në kushte kur niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar eksperiencat e mëparshme të realizuara. Përsa më sipër referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ankimues lidhur me përvojën në punë të kompanisë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë një vlerësim të arsyeshëm.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi mjetet e paraqitura nga operatorët e tjerë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se këto pretendime janë të pambështetura në fakte dhe si të tilla nuk duhet të merren në konsideratë.

IV

Përsa më sipër në përfundim në mbështetje të nenit 63 pika 3 5 dhe 6 e LPP-së si dhe VKM-së RrPP-së kreu shqyrtimi i ankesave neni 78 Ankesa në autoritetin kontraktor Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës njëllojësi vendosi:

Refuzimin e ankesës.

Kopje e këtij vendimi do ti komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor si dhe do ti komunikohet dhe ankimuesit.

Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit komisioni për shqyrtimin e ankesës i komunikon vendimin ankimuesit edhe ë adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit.[.....]

II.7. Në datën 01.12.2020, operatori ekonomik ankimues “Victoria Invest” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor,

II.8. Në datën 15.12.2020 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.9601/1prot., datë 14.12.2020, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 30 pika 2 të **Vendimit nr.596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik**, në të cilin parashikohet se *“Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”*, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesave ka lidhje me vendimet dhe veprimet e tjera të autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar, parashikohet se: *“3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:*

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;*
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;*
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;*
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Në datën 12.11.2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar procesin e vlerësimit të ofertave të dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së kufizuar. Konkretisht, referuar kriterit të përcaktimit të ofertës fituese *oferta ekonomike më e favorshme*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar në total me 81 pikë nga 100 pikë operatorin ekonomik Victoria Invest International shpk, 88.2 pikë BOE “Alko Impex General Construction” dshh& “Alko Impex General Construction” shpk, 86.133 pikë operatorin ekonomik “2T” shpk dhe 75.8 pikë BOE “IDK Konstruksion” shpk& “4 A-M” shpk.

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është mbajtur procesverbali nr.4 ku argumentohet si vijon: *Në lidhje me kriterin Cilësia (metodologjia e zbatimit të punimeve përvoja e personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimi i cilësisë plani i mobilizimit krahasimi është bërë midis kompanive konkurruese. Lidhur me kriterin Cilësia OE*

VICTORIA INVEST sh.p.k. ka paraqitur dokumentin e metodologjisë i përshkruar në 38 faqe nga të cilat 17 faqe janë figura të skemave të përkohshme të menaxhimit të trafikut në rast të punimeve në rrrugë (kopje materiali i specifikimeve teknike, pjesë e dokumentave të tendrit). Përvec të tjerave në faqen 4 të tij thuhet se do të ngrihen 2 qendra të mirëmbajtjes (pikat e mbeshtetjes dhe mirëmbajtjes PMM) në kuptimin e kantierëve të cilat do të shërbejnë si pika ndërhyrje të domosdoshme sidomos në sezonin dimëror. Në vijim përshkruhet vetëm një nga këto kantiere dhe konkretisht ai në Elbasan. Pra ky përshkrim është i paplotë (-1 pikë). Në vazhdim nuk evidentohet në asnjë dokument plani i sigurimit teknik(-1pikë). Gjithashtu mungon plani i menaxhimit të aksidenteve dhe ndihmës së shpejtë (-1 pikë). Gjithashtu mungon plani i menaxhimit social dhe mjedisor (-1 pikë). Dokumenti me planin e menaxhimit të cilësisë është paraqitur si material i përkthyer nga gjuha e huaj (i papërshtatur me gjuhën shqipe). Ky material nuk jep një panoramë të qartë të planit të menaxhimit të trafikut (-1 pikë). **Më tej KVO në analizën e kriterit mbi disponueshmërinë e makinerive dhe pajisjeve konstatoi se një pjesë e mjeteve për të cilat operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë mos angazhimi rezulton të jetë e angazhuar në kontratën lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar për ndërtimin e lotit 3 të unazës së Tiranës. Meqënëse rezulton që ky opearator të ketë bërë deklaratë të rreme, KVO vendos ta penalizojë me 3 pikë për këtë kriter.[...]**

III.1.2. Në datën 23.11.2020 me shkresën nr.8945/2 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues duke argumentuar ndër të tjera se:

- Lidhur me prenimin e operatorit ekonomik ankimues mbi vlerësimin me pikë për treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementët e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura personelit kryesor disponueshmërisë së pajisjeve kryesore organizimi i sitit siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit grafikut të punimeve dhe cdo aktiviteti tjetër sic mund të përcaktohet nga punëdhënësi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se operatori ekonomik ankimues ka pasur në dispozicion kohën e mjaftueshme për të përgatitur ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. **Pavarsisht kësaj konstatohet se operatori ankimues për plotësimin e kriterit lidhur me mjetin Grejder ka paraqitur të njëtin mjet sikurse në kontratën me objekt : Loti 3 të Unazës së Tiranës, ky objekt pavarsisht se nuk ka filluar punimet nuk rezulton të jetë i anuluar nga autoriteti kontraktor. Pra rezulton që ky operator të ketë bërë deklaratë të rreme lidhur me disponueshmërinë e mjeteve. Për këtë arsye pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.**

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin për prokurimin publik. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përzgjedhur si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, ofertë ekonomike më të favorshme, bazuar kjo në nenin 55 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, autoriteti ka përcaktuar tre komponentë mbi të cilën do të kryhet edhe procesi i vlerësimit, Cilësia, Eksperienca dhe Cmimi me peshë specifike secilën prej tyre. Referuar komponentit “Cilësia”, në dokumentet e procedurës, autoritetit ka sqaruar se në këtë komponent përfshihen: “Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit

kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi” Gjithashtu, në shtocjën 10 “Kriteret e Veccanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka parashikuar se: “2.3.11 Makinerite e mesiperme nuk duhet të jene të angazhuara në kontrata të tjera. Per kete të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklaratës. Ne rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.**”

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjen me vend të ndalet në dy pyetje kërkimore, të cilat do të shërbejnë mbi zgjidhjen e konfliktit administrative objekt gjykimi:, së pari me momentin procedural që mund të ngrihen pretendime mbi dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi dhe mbi tagrat dhe kompetencat e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi konstatimin e një deklarimi të rremë për qëllime kualifikimi. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se lloji i procedurës së përzgjedhur nga ana e autoritetit kontraktor është procedurë e kufizuar në kuptim të nenit 31 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, procedurë e cila është me faza, ku në fazën e parë operatorët ekonomikë dorëzojnë dokumentacionin ekonomiko-financiar dhe teknik për kualifikim ndërsa në fazën e dytë, vetëm operatorët e para kualifikuar paraqesin njëherazi edhe ofertën ekonomike sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht se këto dy faza janë faza të ndryshme procedurale. Ndërkohë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nuk mund të anashkalojë një rregullim specifik që ka parashikuar ligjvënësi në nenin 47 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku thuhet se: “Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës. Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji” Në rastin konkret, ligjvënësi ka parashikuar si momentin procedural që mund të kryhet verifikimi i dorëzimit të dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi, ashtu edhe organi që e kryen atë. Konkretisht, neni 47 i ligjit për prokurimin publik parashikon se skualifikimi për paraqitjen e dokumenteve të rreme shtrihet në çdo kohë deri në momentin e lidhjes së kontratës. Kështu, autoriteti kontraktor ndodhet brenda afateve procedurale të konstatimit dhe skualifikimit të ofertës së operatorëve ekonomikë në kushtet kur ky i fundit ka paraqitur deklaram të rremë për qëllime kualifikimi. Sa më sipër, në shtrirjen e së drejtë në kohë, për konstatimin e dorëzimit të dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ndodhet brenda afatit procedural, pasi kufizimi i vetëm lidhet me momentin e lidhjes së kontratës. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit) KPP konstaton se në relacionin e ndryshimeve të ligjit për prokurimin publik, konkretisht të nenit 47 të ligjit, ndryshuar me ligjin nr. 47/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar është argumentuar se: “Pra, për ta bërë më të qartë këtë fazë, deri kur autoriteti kryen verifikime propozohet që të qartësohet shprehja e përdorur në këtë nen duke zëvendësuar fjalët “deri në fazën e shpalljes së kontratës” me “deri në momentin e lidhjes së kontratës” Gjithashtu, është ndryshuar edhe emërtimi i këtij neni “Skualifikimi i ofertuesve” në “Raportimi i skualifikimit”, kjo për ta lidhur me përmbajtjen e tij.” Konkretisht, qëllimi i ligjvënësit ka qenë të qartësojë të drejtën e autoritetit kontraktor për të kryer verifikime mbi dorëzimin e deklaratave

/dokumenteve të rreme për qëllime kualifikimi deri në momentin e lidhjes së kontratës. Gjithashtu, KPP konstaton se ligjvënësi nuk ka parashikuar se cila strukturë mund të kryejë konstatimin, (KVO, KSHA), kompetencat e të cilëve janë rregulluar qartësisht në rregullat për prokurimin publik, por ka nënvizuar se **është autoriteti kontraktor** përgjegjës për të kryer këto verifikime, pra përfshirë një nga strukturat e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë me një nivel më të ulët pikësh për komponentin përkatës “Cilësia” me arsyetimin se operatori ka paraqitur të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, por duhet të zbatojë parashikimet e nenit 47 të ligjit nr.9643 dtaë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, të skualifikojë operatorin ekonomik dhe të ndjekë veprimet proceduriale të parashikuar nga ky nen. Është përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktor, i cili ka kryer verifikimet e nevojshme dhe ka konstatuar se operatori ekonomik ka dorëzuar një deklaratë të rremë, konkretisht, deklaratën në mbështetje të kriterit 2.3.11 të shtojcës 10 të dokumenteve të procedurës së prokurimit, për sa kohë që kjo është konstatuar nga autoriteti kontraktor dhe brenda momentin procedural të njohur nga ligji (para nënshkrimit të kontratës).

Sa më sipër, në zbatim të nenit 30 pika 2 të **Vendimit nr.596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik**, në të cilin parashikohet se “2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre” Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk mund të shqyrtojë në themel pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për kundërshtimin e vlerësimit me pikë ndaj këtij të fundit, pasi ky operator ekonomik, referuar konstatimeve të autoritetit kontraktor duhe të ishte skualifikuar në zbatim të nenit 47 të ligjit për prokurimin publik. Konstatimi i paraqitjes së dokumentacionit të rremë, në kuptim të nenit 47 të ligjit për prokurimin publik, nuk mund të passjellë uljen e pikëve të operatorit ekonomik ankimues, por kryerjen e veprimit procedural të skualifikimit të këtij të fundit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, njëzëri:

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria Invest ” shpk për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65733-07-16-2020, me objekt: Loti IV “Mirëmbajtje me performancë K/Sauk - Sanatorium, Sauk - Km 29 - rot. re Shijon - Ura e Zaranikës, Km22 - Qytezë Krrabë - Objekti X, Rotondo Sauk - Sauk i Vjetër, Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj, Vaqarr - Vishaj”, me fond limit 263.424.859 (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktor të zbatojë parashikimet e nenit 47 të ligjit nr.9643 dtaë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, duke skualifikuar operatorin ekonomik “Victoria Invest International” shpk dhe të ndjekë veprimet proceduriale të parashikuar nga ky nen.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Victoria Invest International” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1593 Protokoli, Datë 01.12.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri